



UNIVERSITETI I SHKODRËS
”Luigj Gurakuqi”
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT
DEPARTAMENTI I ARTEVE

PROGRAMI I KONKURSIT TË PRANIMIT
NË PROGRAMIN E STUDIMIT PEDAGOGJI MUZIKORE

Pranimi i kandidatëve në **Programin e Studimit Bachelor në Pedagogji Muzikore** bëhet mbi bazën e rezultatit të konkursit që zhvillohet pranë Departamentit të Arteve, Fakultetit të Shkencave të Edukimit, të Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, në bazë të kritereve të propozuara nga Departamenti i Arteve si më poshtë:

Gjithsej 300 pikë

Nota mesatare e shkollës së mesme, për të gjitha vitet, përfshirë edhe provimin e Maturës Shtetërore 30% të totalit – 90 pikë

Konkursi i Pranimi 70% të totalit – 210 pikë, (Minimumi i pikëve për fituesin është 60)

Konkursi do të zhvillohet në tre faza:

Faza e parë:

Provimi me shkrim në Solfezh dhe në Harmoni. Në Solfezh do të ketë diktat ritmik dhe diktat melodik (me një dhe me dy zëra), ndërsa në Harmoni studentit do t’i jepet të zgjidhë (me shkrim) dy ushtrime, një me melodi të dhënë dhe një tjetër me bas të dhënë.

Ndarja e pikëve të kësaj faze do të jetë si më poshtë:

a) Provimi me shkrim në solfezh ku do testohen të gjitha njohuritë e formimit ritmik të konkurentëve, duke qënë një diktat mesatar i figurave ritmike të realizuara gjatë ciklit 9-veçar dhe të mesëm. **Ky provim përmban 16 % të fazës së parë (33 pikë).**

b) Provim me shkrim në harmoni, ku konkurentët do harmonizojnë një linjë melodike dhe një basi të dhënë brënda njohurive të marra gjatë studimit në ciklin e mesëm ku programi i lëndës së harmonisë shkon me mbylljen e librit harmonia 1. **Ky provim përmban 14 % të fazës së parë (30 pikë).**

Kjo fazë e konkursit ka në dispozicion 21 % (tridhjetë përqind) e pikëve (63 pikë).

Faza e dytë:

Në provimin e formimit të përgjithshëm muzikor, konkurentët do t'i nënshtrohen një provimi me shkrim i cili synon të testojë njohuri të formimit të përgjithshëm kulturor dhe sidomos njohuri të formimit muzikor të marra në lëndët e ndryshme muzikore në shkollën e mesme (nocione të teorisë muzikore, të harmonisë, të analizës së formës, të historisë së muzikës, të folklorit, etj). Kjo fazë e konkursit ka në dispozicion 60 % (gjashtëdhjetë përqind) të pikëve (126 pikë).

Pyetje orientuese të formimit të përgjithshëm.

Histori Muzike 75 Pikë

Mesjeta

Korali Gregorian,
Tradita e trubadureve,
Lindja e polifonisë,
Zhvillimi i shkrimit muzikor.

Rilindja

Zhvillimi i shkollave polifonike (flamande, e Romes, e Venecias),
Madrigali Italian,
Zhvillimi i muzikës instrumentale.

Baroku

Lindja dhe zhvillimi i operes (kamerata fiorentinase, tradita veneciane, tradita napoletane, Monteverdi, A. Scarlatti, etj),
Muzika për violinë dhe ansambël instrumental (sonata da chiesa, sonata da camera, koncerti grosso).
Corelli,
Vivaldi.
Muzika për organo dhe klavicembalo. J. S. Bach. G. F. Handel.

Klasicizmi

Haydn,
Mozart,
Beethoven.

Romantizmi

Romantikët gjermanë: Schubert, Weber, Schumann, Mendelssohn,
Romantizmi i hershëm në Itali: Paganini, Rossini, Bellini, Donizetti.
Chopin,
Berlioz,
Lizst,
Wagner,
Verdi.

Shkollat kombetare:

Rusia, Çekia, Norvegjia.

Shek. XX

Verizmi:
Mascagni,
Leoncavallo,
Puccini.

Postromantikët

R. Strauss,
G. Mahler.

Impresionizmi

Debussy,
Ravel.

Neoklasicizmi

Stravinsky.

Ekspresionizmi

Schonberg dhe shkolla e dytë vjeneze.
Bartok.

Histori e muzikës shqiptare

Periudha e Rilindjes:

Paloke Kurti,
Frano Ndoja,

Periudha e Pavaresise:

M. Gjoka,
F. Noli,
Th. Nasi,
L. Kurti,
M. Koliqi.

Gjysma II e shek. XX:

P. Jakova,
K. Kono,
C. Zadeja,
T. Daija,
T. Harapi,
N. Zoraqi,

F. Ibrahim, i,
Sh. Kushta,
L. Dizdari,
A. Peci,
Th. Gaqi.

Teori Muzike 15 Pikë

Ritmi,
Melodia,
Intervalet,
Kuintakordet me përmbysje,
Septakordet me përmbysje,
Tonalitetet.

Harmoni 15 Pikë

Libri harmonia pjesa e parë (botim për shkollat e mesme artistike).

Analizë forme 10 Pikë

Motivi,
Fraza,
Fjalja,
Periudha.

Format e vogla muzikore:

Dy pjesëshi thjeshtë,
Tre pjesëshi i thjeshtë,
Tre pjesëshi i përbërë,
Rondo,
Sonata.

Folklor muzikor shqiptar 11 Pikë

Ndarja etnografike e Shqipërisë,
Veçoritë kryesore muzikore të secilës prej tyre,
Instrumentet karakteristike.

Sistemi modal:

Pentatonia,
Modet diatonike (te plotë e te gjymta),
Modet kromatike kryesore.

Kjo fazë e konkursit ka në dispozicion 60 % (gjashtëdhjetë përqind) të pikëve, (126 pikë).

E gjithë literatura e temave të mësipërme bazohet mbi tekstet e shkollave të mesme artistike.

Faza e tretë:

Lojë në instrument.

Konkurentët do të luajnë një pjesë me përzgjedhje të lirë në një instrument muzikor (me parapëlqim pianoforten). Kjo fazë e konkursit ka në dispozicion 10 % (dhjetë përqind) të pikëve totale të konkursit, të konvertuara në **21 pikë**

Dekani i Fakultetit të Shkencave të Edukimit

Prof. As. Dr. Fatmir VADOHEJ